

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS**  
**Komisioni disiplinor – shkalla e parë**  
**Prishtinë date, 31.10.2019**

**Komisioni disiplinor i shkallës së parë** në përbërje ; Dukagjin Zefi – kryetar dhe Luan Salihu e Avni Shala – anëtar, në mbledhjen e mbajtur me date 31.10.2019, shqyrtoi procedurat e hapura nga mbledhja e kaluar si dhe incimet disiplinore të nisura nga komisionet e garave pas përfundimit të ndeshjeve nga java e fundit dhe për të njejtat duke iu referuar raporteve zyrtare conform Dispozitave të Rregullores disiplinore sjelli këto ;

**V E N D I M E ;**

**KF “ FERIZAJ “** nga Ferizaj në procedurë të inicuar disiplinore nga ana e komisionit të garave, për lëshime në organizimin e ndeshjes ; **KF “ Ferizaj “ - KF “ Drita “** e zhvilluar në Ferizaj ( raportet zyrtare; minuta e 69 hujhje e 2 shisheve të PVC dhe 1 të qelqit në fushë në shënjë paknaqësije ).I **hapet procedura disiplinore** deri në kompletimin e lëndës ). Kërkohen raporte plotësuese nga klubi futbollistik “ Ferizaj – personi për siguri nga ajo ndeshje si dhe delegate ndeshjes lidhur me rastin . Afati date 04.11.2019 ( Rregullorja disiplinore neni 11 paragrafi 1 ).

**KF “ VLLAZNIA “** nga Pozharani në procedure të inicuar disiplinore nga ana e komisionit të garave për lëshime në organizimin e ndeshjes; **KF “ VLLAZNIA “ – KF “ UIPIANA “** e zhvilluar në Sadovinë ( raportet zyrtare ; minuta e 45 trajneri vendas Elmaz Halimi vërsulet dhe ofendon gjyqtaret e takimit, te njejtat veprime i kryejnë edhe disa persona të pa autorizuar në afërsi të zhveshtorev pas përfundimit të ndeshjes ) I **hapet procedura disiplinore** deri në kompletimin e lëndës. Kërkohet raport plotësues nga klubi futbollistik “ Ferizaj “ nga Ferizaj – personi për siguri për atë ndeshje lidhur me rastin. ( Rregullorja disiplinore neni 11 paragrafi 1 ).

**KF “ ULPIANA “** nga Lipjani, në procedure të hapur disiplinore nga mbledhje e kaluar e komisionit, për mosudhëtim në zhvillimin e ndeshjes së radhë të Ligës së parë të Kosovës në futboll për kategorinë e juniorëve ; **KF “ A&N “ – KF “ Ulpiana “** , I shqiptohet masa disiplinore ; **Verejtje e fundit .**

**ALBION DOBERLANI** ; lojtar i klubit të futbollit “ **Elita** “ nga Raskova me numër të ID kartelës ; 003227M01, në procedure të pezullimit nga mbledhja e kaluar e komisionit disiplinor , për ndëshkim me karton të kuq në ndeshjen ; KF “ Elita “ – KF “ Dukagjini “ e zhvilluar në Raskovë, bazuar në nenin 39 paragrafi 3 të Rregullores disiplinore ; denohet me ndalesë loje për; 2 ( dy ) ndeshje zyrtare sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

**ARLIND BERISHA** ; lojtar i klubit të futbollit “ **Dukagjini** ” nga Novosella e Gjakovës me numër të ID kartelës; 012820M02 në procedure të hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e komisionit për ndëshkim me karton të kuq në ndeshjen e Ligës së pare kategoria e juniorëve ; **KF “ Elita ” - KF “ Dukagjini ”** e zhvilluar në Raskovë, bazuar në nenin 32 paragrafi 3 ; të Rregullores disiplinore ; **denohet ; me ndalesë loje për 2 ( dy ) ndeshje zyrtare** sipas radhë të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës .

**EDISON SALLAHU** ; lojtar i klubit të futbollit “ **Liria** ” nga Prizreni , në procedurë të inicuar disiplinore nga ana e komisionit të garave , për ndëshkim me karton të kuq , në ndeshjen e kategorisë së juniorëve të superligës së Kosovës në futboll ; **KF “ Liria ” – KF “ Drenica ”** e zhvilluar në Prizren, bazuar në nenin 39 paragrafi 3 të Rregullores disiplinore; **denohet me ndalesë loje për 2 ( dy ) ndeshje zyrtare** sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

**Lojtaret e klubit të futbollit “ DUKAGJINI ” nga Novosella** , , në procedure të hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e komisionit të evidentuar si shkaktar në ndërprerjen e ndeshjës ; **KF “ Dardanet ” – KF “ Dukagjini ”** ( raportet zyrtare ; sulm në gjyqtarin kryesor minuta e 89 e nreshjes ), bazuar ne nenin 48 paragrafi 1 të Rregullores disiplinore ; denohen ; me ndalesë loje ;

1. **Samuel Rrukaj** nr; ID kartelës; 008785M00 ; me ; 5 ( pesë ) ndeshje zyrtare mos lojë sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.
2. **Qendrim Vishaj** me nr ID kartelës; 004212M98 me ; 6 ( gjashtë ) ndeshje zyrtare mos lojë sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës
3. **Kujtim Vishaj** ; me numër të ID kartelës; 008708M92; me 5 ( pesë ) ndeshje zyrtare mos lojë sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

#### **KËSHILLA JURIDIKE**

Pala e pakënaqur në këto vendime ka të drejtë ankese drejtuar komisionit disiplinor të shkallës së dytë – komisionit për ankesa në afatin kohor prej ; 8 ( tetë ) ditëve nga data e sjelljës së këtij vendimi – publikimit të tij në faqën zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës . Ankesa e ushtruar nga ana e pales së ankimuar nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

**Prishtinë, date 31.10.2019**

**Kryetari, Dukagjin Zefi**

